

ANKIMI KUSHTETUES INDIVIDUAL

Sonila BEJTJA

Gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë

Ankimi kushtetues individual në Shqipëri i ka fillesat në vitin 1992 me ligjin “Për dispozitat kryesore kushtetuese” dhe atë për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese. Kompetencat e Gjykatës në lidhje me ankimin kushtetues ishin konceptuar mjaft të gjera, pasi individi mund t’i drejtohej asaj me kërkesë për interpretimin e dispozitave kushtetuese¹ si dhe antikushtetutshmërinë e ligjit për mbrojtjen e të drejtave themelore².

Me miratimin e Kushtetutës në vitin 1998, individi mund t’i drejtohej Gjykatës Kushtetuese vetëm për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Neni 131/f i Kushtetutës parashikonte se Gjykata kryen “gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor...”. Ky parashikim mund të konsiderohej si një hap pas në krahasim me të drejtën e individit të parashikuar para miratimit të Kushtetutës. Në këtë drejtim, Gjykata nuk ka pranuar kërkesat e individëve për shkeljen e të drejtave kushtetuese si e drejta e pronës³ apo e drejta për punë⁴, duke i konsideruar ato jashtë juridiksionit kushtetues. Gjykimi i pretendimeve për shkeljen e së drejtës për një proces të rregullt ligjor u transformua në një nga kompetencat kryesore të Gjykatës Kushtetuese. Në këtë drejtim ajo elaboroi elementët e nocionit të procesit të rregullt duke e zgjeruar jurisprudencën e saj në përputhje edhe me jurisprudencën evropiane. Për sa i përket kësaj kompetence të Gjykatës ka pasur shpesh mendime se ajo nëpërmjet interpretimit të dispozitave kushtetuese mund të bënte edhe interpretimin në aspektin substancial të të drejtave themelore, por një gjë e tillë nuk u arrit në praktikë. Ishte vetë Gjykata Kushtetuese e cila bëri një interpretim të kufizuar të kompetencës së saj duke u fokusuar vetëm në cenimin e të drejtës për proces të rregullt vetëm në aspektin procedural.

¹ Vendim nr.5, datë 15.08.1992

² Vendimet nr.11, datë 27.08.1993; nr.10, datë 30.11.1994; nr.5, datë 28.06.1995; nr.10, datë 31.07.1995; nr.14, datë 08.11.1995

³ Vendim moskalimi nr. 67, datë 15.07.2009

⁴ Vendim moskalimi nr.74, datë 15.6.2012

Zgjerimi i ankimit kushtetues individual u arrit vetëm pas ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore me reformën në drejtësi në vitin 2016. Tashmë Kushtetuta e ndryshuar në nenin 131, shkronja “f” parashikon se: “1. Gjykata Kushtetuese vendos për: ... f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave, përveçse kur parashikohet ndryshe në Kushtetutë.”.

Në mënyrë që ankimi kushtetues individual të këtë sukses në Gjykatën Kushtetuese ai duhet të përmbushë disa elementë të cilat do të trajtohen në vijim.

1. Kërkuesi – individ

Neni 134, shkronja “i” parashikon se Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të individëve, të cilët mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre. Kjo dispozitë gjendet edhe në ligjin për funksionimin dhe organizimin e Gjykatës Kushtetuese, përkatësisht në nenin 71, sipas të cilit çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private ose publike, kur është palë në një proces ligjor ose kur është bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta ka të drejtë t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese.

Për sa i përket personit fizik, ai është përcaktuar qartë nga jurisprudenca kushtetuese qoftë personi madhor ashtu edhe i mitur nëpërmjet prindit ose kujdestarit të tij ligjor. Edhe individët e huaj ose ata pa shtetësi kanë të drejtë t’i drejtohen Gjykatës kur kanë qenë palë në gjykim. Kështu në një rast, Kolegji i Gjykatës evidentoi se neni 16, pika 1, i Kushtetutës garanton të drejtat dhe liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në të si për shtetasit shqiptarë, ashtu dhe për të huajt dhe për personat pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur Kushtetuta e lidh në mënyrë të posaçme me shtetësinë shqiptare ushtrimin e të drejtave dhe lirive të caktuara.

Ndërsa personat juridikë mund t’i drejtohen Gjykatës Kushtetuese në rastin e cenimit të të drejtave të tyre të cilat janë të lidhura me qenien e tyre si persona juridikë. Të tilla përfshihen shoqatat ose organizatat e tjera, si subjekte të së drejtës private, të cilët detyrohen të justifikojnë interesin e tyre të drejtpërdrejtë në çështjen konkrete. Në një rast kërkuësja, një shoqatë, e cila ju drejtua Gjykatës ishte person juridik, i huaj, e regjistruar në një shtet të huaj, por nuk rezultonte që të ishte regjistruar në gjykatat shqiptare. Gjykata në analizimin e legjitimitetit *ratione personae*

vlerësoi se pavarësisht se kërkuesja nuk ishte regjistruar në gjykatat shqiptare, legjitimohej për t'iu drejtuar Gjykatës, pasi justifikonte interesin e saj të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.⁵

Gjykata ka bërë gjithashtu dallimin midis legjitimitit të personave juridikë publikë, që pretendojnë cenimin e të drejtave themelore substanciale, nga legjitimimi i subjekteve të së drejtës publike, që pretendojnë cenimin e të drejtave themelore procedurale. Shteti ose organet përbërëse të tij, me disa përjashtime, nuk mund të konsiderohen subjekte përfitues të të drejtave e lirive themelore substanciale dhe si rrjedhojë nuk legjitimohen për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Në një rast kërkuesi si person juridik publik pretendoi cenimin e parimeve procedurale kushtetuese të ankimit dhe të aksesit në gjykatë. Këto parime nuk mund të cenohen, sepse janë elementë të së drejtës në tërësi që rrjedhin nga thelbi i shtetit të së drejtës dhe garantojnë barazinë e palëve në një proces gjyqësor. Prandaj, dhe ankimi në Gjykatën Kushtetuese për shkeljen e tyre mund të paraqitet nga çdo subjekt duke përfshirë këtu edhe personat juridikë publikë.⁶

Individi që i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual duhet të përmbushë edhe kriterin e interesit të drejtpërdrejtë. Neni 131/f i Kushtetutës i ka dhënë individit të drejtën për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese vetëm për shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese, pra ai nuk mund të paraqesë pretendime për cenimin e të drejtave të personave të tjerë. Kjo nënkupton se vetëm titullari i një të drejte mund ta ushtrojë në mënyrë të vlefshme këtë mjet për të kërkuar mbrojtjen juridike që ai ofron. Po kështu, duhet theksuar se ankimi kushtetues individual nuk barazohet me *actio popularis*.

Sipas nenit 131/1/f, objekt i ankimit kushtetues individual mund të jetë çdo akt i pushtetit publik dhe vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë kushtetuese. Gjykata e ka legjitimuar individin, si person fizik, për të kundërshtuar një ligj ose akt normativ kur ai provon se është bartës i së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar, si dhe provon interesin në lidhje me çështjen, pra cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të së drejtës kushtetuese. Në këtë drejtim, Gjykata ka marrë në shqyrtim kërkesën e një individi i cili, në cilësinë e kandidatit të pavarur në zgjedhje, kundërshtoi një nen të Kodit Zgjedhor me pretendimin se cenonte të drejtën për t'u zgjedhur dhe parimin e barazisë së votave e mundësive të barabarta. Gjykata vlerësoi se dispozita ligjore e kundërshtuar

⁵ Vendimi nr. 38, datë 09.12.2022

⁶ Vendimi nr. 22, datë 26.07.2006

nuk parashikonte nxjerrjen e akteve nënligjore të nevojshme për zbatimin e saj, por ishte drejtpërdrejt e zbatueshme ndaj kërkuesit që prej momentit kur ai është regjistruar për të marrë pjesë në zgjedhje si kandidat i propozuar nga zgjedhësit.⁷

Ndërsa në një rast të fundit, kërkuesja kundërshtonte një dispozitë të Kodit të Procedurës Civile e cila parashikonte mënyrën e njoftimit të palëve në gjykim. Gjykata vlerësoi se kërkuesja legjitimohej pasi dispozita nuk parashikonte nxjerrjen e akteve nënligjore dhe zbatohet drejtpërdrejt nga Gjykata e Lartë për të kryer njoftimin e kërkueses për çështjen e saj, duke shpallur në faqen zyrtare dhe në këndin e njoftimeve në ambientet fizike listën e gjykimeve për seancat gjyqësore, si dhe përbërjen e trupit gjykues, ku përfshihet edhe çështja e kërkueses.⁸

Në një rast Gjykata nuk i ka legjitimuar kërkuesit për kundërshtimin e akteve normative për shkak se nuk kanë arritur të provojnë përpara Gjykatës se në çfarë mase anëtarët e saj ose subjektet, interesat e të cilave ajo mbron, janë në marrëdhënie të tilla që rregullohen nga ligji i kundërshtuar, si dhe se sa reale ose potenciale është pasoja që pretendohet se u është shkaktuar interesave të tyre.⁹

Objekt i ankimit kushtetues individual është edhe vendimi gjyqësor kur individi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar. Në disa raste, Gjykata i ka legjitimuar kërkuesit pasi akti i kundërshtuar është nxjerrë në kuadër të një procesi ligjor të iniciuar mbi kallëzimin penal të tyre, në cilësinë e viktimës nga vepra penale, ndaj ka vlerësuar se ata kanë interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.¹⁰

2. Shterimi i mjeteve

Një tjetër element i ankimit kushtetues individual ka të bëjë me shterimin e mjeteve juridike efektive. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili para se t'i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që

⁷ Vendim nr. 31 datë 04.10.2021

⁸ Vendimi nr. nr. 34 datë 12.06.2023

⁹ Vendim nr. 140 datë 26.06.2023 i Mbledhjes së Gjyqtarëve

¹⁰ Vendime nr. 4 datë 17.01.2023; nr. 33 datë 16.02.2023 të Kolegjit

ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural. Në këtë rast gjen vend parimi i subsidiaritetit, sipas të cilit ankimi paraqitet vetëm nëse shkelja nuk arrin të riparohet brenda sistemit të zakonshëm.

Fillimisht kërkuesi duhet të shterojë sistemin gjyqësor të zakonshëm, duke ankimuar aktin individual që ka dalë në zbatim të një ligji për të cilin pretendon se është në kundërshtim me Kushtetutën. Vetëm më pas, ai mund t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore dhe të ligjit mbi bazën e të cilit janë dhënë këto vendime. Qëllimi i nenit 131, pika 1, shkronja "f" të Kushtetutës, që ka parashikuar rregullin e shterimit të mjeteve juridike është të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin apo riparimin e shkeljeve të pretenduara përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatën Kushtetuese.

Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese ka konsideruar se nuk janë shteruar mjetet juridike nëse çështja është kthyer për rigjykim nga instanca më e lartë gjyqësore. Në këto raste, mungesa e legjitimitetit për të ushtruar ankim kushtetues lidhet dhe përcaktohet nga fakti se procesi vazhdon dhe ka ende mjete të tjera ankimi për të rivendosur të drejtën gjatë shqyrtimit të çështjes në gjykatat e sistemit gjyqësor.

Raste të tjera për të cilat Gjykata ka vlerësuar se nuk janë shteruar mjetet juridike janë edhe vendimi për sekuestrimin e pasurisë, vendimi për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë dhe për mospranimin e kërkesës për revokimin e vendimit të pezullimit, vendimi i gjykatës për shpalljen e moskompetencës lëndore, vendimi i pranimin ose jo të kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit gjatë gjykimit të çështjes nga një gjykatë tjetër, vendimi i gjyqtarit të hetimeve paraprake që ka dërguar për gjyq procedimin penal.

Nga ana tjetër, Gjykata ka konsideruar si vendime për të cilat janë shteruar mjetet juridike vendimet në të cilat është vendosur pjesëtimi i pasurisë trashëgimore apo sendeve në bashkëpronësi, i cili realizohet në dy faza: përcaktimi i rrethit të bashkëpronarëve, sendet që do të pjesëtohen dhe pjesët takuese dhe ndarja në natyrë e sendeve objekt pjesëtimi. Gjykata e ka vlerësuar vendimin e fazës së parë të pjesëtitimit si një vendim përfundimtar për pretendimet që ngrihen në Gjykatën.

Gjykata ka pranuar për shqyrtim ankimin individual për edhe për vendimet e ndërmjetme, me plotësimin e disa kushteve (i) vendimi i ndërmjetëm duhet që të ketë vendosur mbi të drejtën e individit të pretenduar të cenuar, të jetë bërë objekt i ankimit të veçantë dhe të jetë shqyrtuar edhe nga gjykatat më të larta, të cilat të jenë shprehur, qoftë edhe tërthorazi për të drejtën që pretendohet të jetë cenuar. (ii) Po ashtu, ky lloj vendimi i ndërmjetëm duhet të ketë një masë autonomie nga procesi i themelit, në kuptimin që pavarësisht se shqyrtimi gjyqësor i mosmarrëveshjes së themelit vazhdon, vendimi përfundimtar që do të jepet në themel nuk është i aftë të ndryshojë vendimin e ndërmjetëm dhe as të riparojë në masën e duhur efektet që ai ka sjellë. (iii) Po aq rëndësi ka edhe fakti që shkelja e pretenduar të jetë pasojë e drejtpërdrejtë e vendimit të ndërmjetëm të kundërshtuar, pra kërkuesja duhet të provojë se është viktimë e shkeljes të së drejtës kushtetuese. Të tilla vendime janë edhe ato për caktimin e masave të sigurimit personal.¹¹

Gjykata gjithashtu e ka trajtuar kriterin e shterimit të mjeteve juridike për ankimin kushtetues që ka për objekt konstatimin e cenimit të së drejtës së gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, për të cilin GJEDNJ është shprehur se vendimi i Gjykatës Kushtetuese nuk mund të ofrojë dhënien në praktikë të një dëmshpërblimi efektiv sepse ai është deklarativ. Ndryshimet ligjore në Kodin e Procedurës Civile të vitit 2016 parashikuan një mjet juridik ankimi efektiv, i cili garanton si përshpejtimin e procesit gjyqësor, ashtu edhe dëmshpërblimin, pra ofron një rezultat konkret në drejtim të rivendosjes të së drejtës së shkelur për proces gjyqësor brenda afateve të arsyeshme ligjore.¹² Për këto kërkesa Gjykata ka vlerësuar se individit nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion nëse paraprakisht nuk ka ushtruar mjetet e parashikuara nga legjislacioni procedural civil.

3. Afati 4 mujor

Përpara miratimit të reformës kushtetuese dhe ligjore, neni 30, paragrafi i dytë i ligjit për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës parashikonte se *“Kërkesat e individit për shkeljen e të drejtave kushtetuese paraqiten jo më vonë se 2 vjet nga konstatimi i shkeljes”*. Ky afat u konsiderua i gjatë dhe për këtë arsye, në ligjin e ndryshuar u parashikua se ankimi kushtetues individual paraqitet brenda afatit 4-mujor nga konstatimi i cenimit, një afat i cili përputhet me natyrën e

¹¹ Vendim nr. 19 datë 04.04.2023

¹² Vendimi nr. 80, datë 18.12.2017 i Gjykatës Kushtetuese.

gjykimit kushtetues, por edhe me kërkesat e reja të Protokollit 15 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Çështja e afatit 4-mujor të paraqitjes së kërkesës në Gjykatën Kushtetuese është bërë edhe objekt i vendimmarrjes së GJEDNJ-së e cila në disa vendime të fundit ka gjetur shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së në drejtim të së drejtës së aksesit në gjykatë, për shkak të mospranimit të ankimit kushtetues si të paraqitur jashtë afatit ligjor 4-mujor.¹³ Sipas GJEDNJ-së, palët duhet të jenë në gjendje të përfitojnë nga e drejta për të bërë ankim që nga momenti kur marrin dijeni efektivisht për vendimet gjyqësore që u ngarkojnë atyre një barrë ose që mund të cenojnë të drejtat ose interesat e tyre të ligjshme.

Gjykata e ka llogaritur afatin 4-mujor duke filluar nga data e shpalljes së vendimit nga gjykata që ka përfunduar procesin gjyqësor, nëse kërkuesi nuk provon në nivel kushtetues se ka marrë dijeni në një datë të ndryshme dhe nga ana tjetër ka pohuar se është detyrë e palëve që të ndjekin ecurinë e gjykimit të çështjes së tyre pranë Gjykatës së Lartë.

Duke pasur në vëmendje edhe jurisprudencën e fundit të GJEDNJ-së Mbledhja e Gjyqtarëve vlerësoi se momenti i konstatimit të cenimit të të drejtave kushtetuese, nga i cili fillon të rrjedhë afati i paraqitjes së ankimit kushtetues, konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar është bërë efektivisht i disponueshëm për kërkuesin dhe ai është njohur me shkaqet që kanë çuar në vendimmarrjen e kundërshtuar të asaj gjykate, pra kur vendimi është bërë i disponueshëm në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë.

4. Pretendimet duhet të jenë me natyrë kushtetuese

Një tjetër kriter për paraqitjen e ankimit individual është që pretendimet duhet të jenë me natyrë kushtetuese. Kështu individët mund të ngrenë pretendime vetëm për sa u përket shkeljeve me natyrë kushtetuese, por nuk mund që të ngrenë pretendime për mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit nga gjykatat e zakonshme ose për mënyrën e vlerësimit të provave nga ana e tyre. Gjykata në jurisprudencën e saj ka evidentuar dallimin që ekziston midis mënyrës së marrjes së provave dhe vlerësimit të tyre në procesin gjyqësor. Vlerësimi, dobishmëria dhe rëndësia e tyre provuese në një çështje konkrete janë, si rregull, detyrë e gjykatave të sistemit gjyqësor, ndërsa verifikimi i ligjshmërisë së krijimit dhe marrjes së provave i nënshtrohet edhe kontrollit të kësaj Gjykate, pasi ky aspekt i gjykimit ka lidhje të drejtpërdrejtë me procesin e rregullt ligjor.

¹³ “Supergrav Albania” sh.p.k. kundër Shqipërisë (*aplikimi nr. 20702/18*)

Gjykata mund dhe duhet të investohet kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për mënyrën e marrjes së provave, por jo të vlerësimit të tyre. Është vetë gjykata e zakonshme që vlerëson nëse provat duhet të merren dhe mënyra e vlerësimit dhe konkluzionet lidhur me to janë, gjithashtu, në kompetencë të saj.

5. Konkluzion

Reforma në drejtësi ndryshoi kufijtë e kontrollit kushtetues të ankimit kushtetues individual, duke e zgjeruar atë në drejtim të të drejtave themelore të njeriut, duke i mundësuar individëve që t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese për çdo të drejtë dhe liri themelore kushtetuese dhe duke i lejuar Gjykatës të shprehet në aspektin substancial për çdo ankim individual kushtetues. Tashmë, individi mund të kundërshtojë drejtpërdrejtë çdo akt të pushtetit publik, kur gëzon një të drejtë apo liri që cenohet nga ky akt.

Me zgjerimin e ankimit kushtetues individual Gjykatës Kushtetuese do t'i jepet mundësia të korrigjojë shkeljet e të drejtave kushtetuese brenda sistemit gjyqësor shqiptar, përpara se individi t'i drejtohet Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Megjithëse kjo mund të konsiderohet si një kompetencë e re e Gjykatës, ajo po mundohet të elaborojë disa standarde në përputhje edhe me jurisprudencën e GJEDNJ-së, duke e konsoliduar ankimin kushtetues individual.